VENDIM
Nr. 74, datë 13.4.2022

MBI VLERËSIMET E ERE-s PËR KOSTOT E AKTIVITETIT TË FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1.5.2022–31.12.2022

Në mbështetje të neneve 83 dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar; VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike"; "Metodologjisë së Përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 189, datë 23.11.2017;
Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.486/3 prot., datë 11.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve "Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.5.2022–31.12.2022.

Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 486/3 prot., datë 11.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve "Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.5.2022–31.12.2022",

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. nuk ka paraqitur aplikim për miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga FSHU sh.a.

- ERE, me vendimet e Bordit nr. 233 dhe nr. 234, datë 19.11.2021, ka vendosur fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022 dhe shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022–2024.

- ERE, me shkresës nr. 925/4 prot. datë 16.11.2021, ka njoftuar shoqërinë FSHU sh.a. mbi aplikimet për tarifat e rrjeteve të operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të përcjellë në ERE, pritshmërinë mbi të ardhurat e kërkuara si pasojë e transferimit të kostove të rrjetit të kërkuara nga operatorët OSSH sh.a. dhe OST sh.a., kostove të pritshme të blerjes së energjisë dhe kostot e tjera të aktivitetit të shoqërisë FSHU sh.a.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 10420 prot., datë 6.12.2021 shprehet, se: "është në pritje të vendimeve të ERE-s për tarifat dhe çmimet lidhur me transferimin e kostove të rrjetit për klientët tarifore dhe mbështetur ne vendimet dhe deklaratat e Qeverisë së Shqipërisë, FSHU pret mosndryshim të çmimeve të shitjes së energjisë për klientët në nivelin e tensionit 0.4 kV.".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021, ndër të tjera vendosi: Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 214, datë 15.12.2020, deri në vlerësimin e ERE-s për transferimin e kostove të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike te çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- ERE vlerësoi kostot e aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal duke konsideruar transferimin e kostove të aktivitetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe kostot e blerjes së energjisë elektrike duke përllogaritur efektet e tyre në çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga FSHU sh.a. për vitin 2022. Ky vlerësim u bazua në vlerësimet e kryera nga ERE në periudhat paraardhëse, si dhe të dhënat e përcjella nga FSHU sh.a. për 10-mujorin e vitit 2021, në zbatim të "Metodologjisë mbi përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë

elektrike me pakicë, te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017.

- Të ardhurat e realizuara mbi/nën çmimin mesatar të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 2015–2021 nga aktiviteti i shërbimit të furnizimit universal, janë konsideruar si të ardhura të korrigjueshme për vitin 2022 në zbatim të "Metodologjisë mbi përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017.
- Sasia e parashikuar për t'u shitur nga shoqëria FSHU sh.a., për klientët fundorë të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV, është 4,613 gwh.
- Kostot administrative të aktivitetit të furnizimit të përllogaritura për FSHU sh.a., për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022 janë vlerësuar 1.06 lekë/kwh.
- Asambleja e Përgjithshme e KESH-it, me vendimin nr. 1349/1, datë 16.2.2022, "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2022 parashikimin 2023–2026", ka vendosur ndër të tjera se çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që shërbehen nga FSHU sh.a. do të jetë 2.6 leke/kwh.
- Kostoja e transmetimit është llogaritur bazuar në tarifën prej 0.85 lekë/kwh.
- Kostoja për shpërndarjen e energjisë elektrike në nivelin e tensionit 0.4 kV është llogaritur bazuar në tarifën prej 6.42 lekë/kwh.
- Kostoja e financimit të kapitalit të punës është vlerësuar sipas normës 3% ndaj kapitalit të punës së shoqërisë FSHU sh.a..
- Marzhi i fitimit për aktivitetin e shërbimit të furnizimit universal është vlerësuar sipas normës së pranuar nga ERE prej 2.2%.
- Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike prej 10.7 lekë/kwh pritet të rikuperojë të gjitha kostot e aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal pas transferimit të kostove të blerjes, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Të ardhurat e realizuara mbi/nën ato të lejuara do të korrigjohen nga ERE, në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017, në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a., sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022 janë ato të miratuara me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 252, datë 21.12.2021, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi. (bashkëlidhur tabela).
2. Klientët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe/ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk janë subjekt i parashikimeve të pikës 1, të këtij vendimi.
3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Miratuar me vendim Bordit ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022.

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1 MAJ - 31 DHJETOR 2022		
Përshkrimi	**Çmimi i energjisë aktive (Lekë/kWh)**	****Çmimi i energjisë aktive në orar pik (Lekë/kWh)**
*** Çmimi i shitjes për Klientët në 20 kV**	**11**	**12.65**
*** Çmimi i shitjes për Klientët në 10/6 kV**	**11**	**12.65**
*** Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV**	**7.1**	**8.17**
*** Çmimi i shitjes për Klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU**	**12.4**	**14.3**
Klientë në 0.4 kV	**14**	**16.1**
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	**7.6**	**8.74**
Objekte kulti/bashkësi fetare	**9.5**	
Familjarë	**9.5**	
Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambjentet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	**9.5**	
** Klientët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe /ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk jane subjekt i këtyre cmimeve*		
***Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është :*		
- Për periudhen 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
- Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		